



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË
KOMUNËS SË SUHAREKËS PËR VITIN 2019**

Prishtinë, Korrik 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Suharekës, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm *Naser Arllati*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *Albesa Tolaj-Ramosaj* dhe anëtarët *Abdurrahmon Berbatovci* dhe *Mexhit Ferati*, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Shkëlqim Xhema*.


TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	5
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore	6
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	8
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	21
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja	26
Shtojca II: Letër e Konfirmimit.....	28

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i komunës së Suharekës për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Procesi i përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore është menaxhuar në pajtim me legjislacionin në fuqi, me përjashtim të keq klasifikimit të shpenzimeve që kanë ndikuar në theksim të çështjes.

Menaxhimi financiar dhe Kontrolli - edhe pse kontrollet e brendshme kanë operuar në mënyrë efektive, dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: të hyrat, në mallra, subvencione, investime kapitale, pasuritë jo financiare, të arkëtueshmet si dhe obligimet.

Përgjigja ndaj rekomandimeve të vitit paraprak nuk po adresohet në nivelin e kërkuar. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, pesë (5) rekomandime janë zbatuar, dy (2) rekomandime janë zbatuar pjesërisht, një ishte mbyllur ndërsa katër (4) rekomandime nuk ishin zbatuar ende.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Më gjerësisht shih kapitullin 1 të këtij raporti.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna. Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunës gjatë procesit të auditimit.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Komunës së Suharekës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve së Komunës së Suharekës për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-së dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Komuna. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Theksimi i çështjes

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se përmes planifikimit buxhetor Komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në kategori ekonomike jo adekuate. Nga kategoria e investimeve kapitale kishte paguar për mallra e shërbime si dhe anasjelltas. Në këtë raporte kjo çështje është trajtuar tek gjetja B1. Opinioni ynë nuk është i modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Kryetari i Komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në webfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna në përgjithësi ka të vendosur sistem të mirë të kontrolleve në raport me obligimet statutores të saj. Megjithatë, fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime, janë parandalimi i keq klasifikimit të shpenzimeve. Gjithashtu, rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet kontrolleve në këto fusha: menaxhimin e të hyrave, pranimin e mallrave dhe shërbimeve, menaxhimin e subvencioneve, vonesave në realizimin e investimeve kapitale dhe planifikimin e prokurimit, menaxhimi i pasurive, menaxhimi i të arkëtueshmeve si dhe vonesave në pagesa.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	16,260,041	16,659,235	15,572,696	93%	16,307,057	13,606,775
Granti i Qeverisë - Buxheti	13,859,013	13,859,013	13,656,163	99%	14,176,544	11,707,336
Të bartura nga viti paraprak ³ -	-	515,908	340,091	66%	526,389	682,570
Të hyrat vetjake ⁴	2,239,252	2,239,252	1,537,975	69%	1,456,155	1,183,517
Donacionet e jashtme	-	47	-	-	83,068	-
Financimi nga Huamarrja	161,776	45,015	38,467	85%	64,901	33,352

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 399,194€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak në vlerë 515,908€ dhe 47€ nga donacionet e jashtme, ndërsa kishte zvogëlim të buxhetit për 116,761 nga financimi prej huamarrjes.

Në vitin 2019, komuna ka shpenzuar 93% të buxhetit final ose 15,572,696€, me një përkeqësim prej 2% krahasuar me vitin 2018. Megjithatë, realizimi i buxhetit mbetet në nivel të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	16,260,041	16,659,235	15,572,696	93%	16,307,057	13,606,775
Pagat dhe Mëditjet	8,448,110	8,448,110	8,229,756	97%	8,174,021	7,921,188
Mallrat dhe Shërbimet	1,716,144	1,615,739	1,468,962	91%	1,375,493	1,028,221
Shërbimet komunale	294,700	317,154	273,881	86%	244,473	211,604
Subvencionet dhe Transferet	300,000	300,510	298,620	99%	1,278,201	278,401
Investimet Kapitale	5,501,087	5,977,722	5,301,477	89%	5,234,869	4,167,361

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

- Buxheti të kategoria e pagave dhe mëditjeve nuk ka pasur ndryshime në raport me buxhetin fillestar;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte zvogëluar në raport me atë fillestar në vlerë prej 100,405€ si rezultat i shkurtimeve buxhetore, ndërsa buxheti për shërbimet komunale ishte rritur për 22,454€ si rezultat i rritjes së shpenzimeve të rrymës për ndriçim të komunës;
- Rritja e buxhetit final për 510€, krahasuar me buxhetin fillestar për kategorinë e subvencioneve dhe transfereve ishte si rezultat i të hyrave vetanake të bartura nga viti paraprak; dhe
- Buxheti final për shpenzime kapitale kishte rritje për 476,635€, e cila ishte si rezultat i të hyrave vetanake në vlerë prej 471,496€, financimit përmes huamarrjes në vlerë 5,092€ si dhe donacioneve të jashtme në vlerë 47€.

Çështja B1 - Keq klasifikimi i shpenzimeve

Gjetja Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike” shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Sic kemi paraqitur të theksimi i çështjes, komuna ka paguar 489,208€⁵ nga kategoria e investimeve kapitale për mallra dhe shërbime si dhe 7,777€⁶ nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve për investime kapitale. Sipas komunës këto janë pasojë e buxhetit të kufizuar për mallra dhe shërbime, të cilat janë të domosdoshme, andaj edhe ishin aprovuar me ligjin e buxhetit.

Ndikimi Pagesat e bëra nga kategoria jo-adekuate, ndikojnë në keq klasifikimin e shpenzimeve në Pasqyrat Financiare të Komunës dhe si të tilla japin informata jo të sakta për shfrytëzuesit e PFV-ve.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo ridestinin të mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate

2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2019 ishin në vlerë 1,738,348€. Ato kanë të bëjnë me: të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja, taksat administrative, etj. Gjithashtu, komuna kishte edhe të hyra indirekte të mbledhura nga dënimet në trafik, gjobat e gjykatave dhe gjobat nga Agjencia e Pyjeve në vlerë 107,122€.

Tabela 3. Të hyrat(në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Pranimet	% e pranimeve 2019	2018 Pranimet	2017 Pranimet
Të hyrat tatimore	896,672	896,672	766,843	86%	685,035	566,800
Të hyrat jo tatimore	1,342,580	1,342,580	971,505	72%	896,594	965,804
Totali	2,239,252	2,239,252	1,738,348	78%	1,581,629	1,532,604

⁵ Për kontratën “Mirëmbajtja e Hapësirave Gjellbëruese në komunën e Suharekës” janë 11 pagesa me vlerë 130,805€ dhe për kontratën “Shërbime për realizimin e vitalizimit të infrastrukturës për funksionalizimin e projektit " Shtretërit Shtëpiak”” janë 10 pagesa me vlerë 219,715.50€, për kontratën “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve” janë 4 pagesa me vlerë 91,087€ dhe për kontratën “ Shërbimet e varrimit” janë gjithsejtë 10 pagesa me vlerë 47,600€.

⁶ Renovimi i sallës së Shkollës së Mesme Teknike “S.Luarasi” -Suharekë.

Të hyrat e arkëtuara ishin 78% e të hyrave të planifikuara. Lidhur me testet tona, ne kemi trajtuar si në vijim:

Çështja A1 - Mos verifikimi i pronave tatimore

Gjetja Komuna nuk ka arrit të kryej verifikimin e së paku 20% të pronave të paluajtshme, siç kërkohet me Ligjin për tatimin në pronën të paluajtshme Nr. 06/L-005.

Komuna në vitin 2019, prej 14,800 pronave të regjistruara kishte arritur të kryej verifikimin e vetëm 2,379 apo 16% të pronave të paluajtshme.

Sipas zyrtarëve komunal mos verifikimi i pronës kishte ndodhur në mungesë të pajisjes me kohë më teknologji të re të nevojshme për përkrahje të sistemit të ri të tatimit në pronë dhe nevojës për pajisje me teknologji të re për verifikim të pronave.

Ndikimi Mos verifikimi i 20% të pronave ndikon negativisht në vlerësimin dhe faturimin real të tatimit në pronë dhe mund të rezultojë edhe me nënvlerësimin e të hyrave nga kjo kategori.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të siguroj se verifikimi i pronave komunale do të bëhet ashtu siç parashihet me ligj duke bërë verifikimin e pronave së paku 20 % në vit, për të reflektuar gjendjen reale të pronave të tatuara, që rezulton me të hyra të sakta komunale si dhe performancë më të mirë buxhetore.

Çështja A2 - Mos aplikimi i taksës vjetore për shfrytëzuesit e pronës publike komunale

Gjetja Sipas kontratës nr. 597 të lidhur me datë 14.10.2009 në mes shfrytëzuesit të pronës publike dhe Komunës së Suharekës për shfrytëzimin e pronës komunale në Zonën Industriale për "Prodhimin e elementeve nga betoni", palët ishin pajtuar që afati i qiradhënies të jetë 99 vite përkatësisht Neni 2 i kontratës, me një shumë prej 2,450€ në vit e specifikuar në Nenin 3 të kontratës.

Lidhur me këtë, ne kemi identifikuar se komuna nuk kishte bërë ngarkesë vjetore për shfrytëzuesin e pronës ashtu siç parashihej në kontratë që nga viti 2014. Kjo kishte ndodhur meqenëse komuna në vitin 2014 kishte formuar një komisioni për mbikëqyrjen dhe realizimin e kontratave për shfrytëzim të pronës komunale i cili në atë kohë kishte rekomanduar shkëputjen e kontratës në fjalë si rezultat i mos përmbushjes së qëllimit të dhënies së pronës në shfrytëzim.

Në mungesë të ndonjë vendimi nga Kryetari i Komunës për shkëputjen e kontratës, zyrtarët përgjegjës nuk kishin faturuar shumën vjetore për firmën në fjalë, pavarësisht që firma vazhdonte të shfrytëzojë pronën komunale sipas kushteve të kontratës. Pas rekomandimit nga ana jonë komuna kishte ngarkuar retroaktivisht biznesin për periudhën sa nuk ishte ngarkuar.

Ndikimi Mos aplikimi i taksës vjetore për shfrytëzuesit e pronës publike komunale përveç që ka dëmtuar buxhetin e komunës, mund të shkaktojë pakënaqësi tek qira marrësit e tjerë si dhe rrit rrezikun e mos pagesave të qirasë vjetore nga shfrytëzuesit. Kjo mund të ndikoj në rritjen e borxheve për të hyrat nga shfrytëzimi i pronave komunale.

Rekomandimi A2 Kryetari i komunës duhet të forcojë kontrollet në menaxhimin e pronave të paluajtshme të dhëna në shfrytëzim, si dhe të sigurojë që çdo pronë të ngarkohet me taksë, në përputhje me kushtet dhe hapësirën shfrytëzuese të pronës komunale.

2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për 2019 është 8,448,110€, ndërsa shpenzimi ishte 8,229,756€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 1,316 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 1,309€. Gjatë vitit 2019 ishin punësuar 9 të rinj. Ne kemi testuar 47 mostra për teste substanciale në vlerë 22,589€, si dhe 13 mostra për teste të pajtueshmërisë.

2.1.3 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë komunalit) në vitin 2019 ishte 1,932,893€, prej tyre ishin shpenzuar 1,742,843€. Ato kanë të bëjnë me furnizime me material shpenzues, furnizim me dru për ngrohje, shërbime kontraktuese, intelektuale dhe këshillëdhënëse, mirëmbajtje, shërbime komunale dhe shpenzime të tjera.

Kemi testuar 29 mostra për teste substanciale në vlerë 123,479€ si dhe 8 mostra për teste të pajtueshmërisë. Për këto ne kemi trajtuar çështjen si në vijim

Çështja C1 - Pranimi i shërbimeve dhe furnizimeve jo sipas rregullave

Gjetja Sipas nenit 8 pika 4 të Rregullës Financiare 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare, Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) me vendim duhet të formojë Komisionin për Pranimin e Pasurisë jo Financiare, i cili ka përgjegjësitë të bëjë verifikimin e sasisë, cilësisë, llojin dhe vlerën e pasurisë jo financiare të pranuar. Ndërsa sipas nenit 7, pika 4 të udhëzimit të brendshëm 01-Nr.7011/1-2008 për përdorimin e automjeteve zyrtare, Komisioni duhet të raportoj në formë të shkruar mbi kryerjen e shërbimeve, kualitetin dhe një kopje t'i dërgohet edhe zyrës së prokurimit i cili raport i bashkëngjitet faturës për ekzekutimin e pagesës për kryerjen e riparimit dhe mirëmbajtjes së automjetit.

Gjatë testimit të pagesave kemi vërejtur si në vijim:

- Në një rast furnizim me material për zyre në vlerë prej 1,945€ pranimi nuk ishte bërë me vendim e as nga komisioni por ishte bërë nga drejtori i njësisë kërkuese dhe menaxheri i kontratës; dhe
- Në 2 pagesa me vlerë të përbashkët financiare prej 8,615€ porositja dhe pranimi i shërbimeve për mirëmbajtje dhe riparim të automjeteve ishte bërë nga një person i vetëm, duke mos respektuar kërkesat e udhëzimit të brendshëm.

Sipas menaxhmentit, kjo ka ndodhur për shkak se drejtoritë përkatëse nuk i kanë bërë kërkesat me kohë ZKA-së për formim të komisionit për pranim të furnizimeve apo shërbimeve.

Ndikimi Pranimi i shërbimeve apo furnizimeve në mungesë të komisionit relevant të pranimit, mund të shpie në kryerjen e pagesave për të cilat nuk ka siguri se janë pranuar shërbimet apo furnizimet sipas kushteve të kontratës.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të sigurojë që komisionet përkatëse për pranimin e shërbimeve apo furnizimeve janë caktuar me kohë, pranimi i mallrave/shërbimeve është bërë sipas rregullave të përcaktuara dhe që pagesat bëhen bazuar në raportet e pranimit.

2.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 300,510€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 298,620€. Shpenzimet kryesisht kishin të bëjnë me bursa për studentë, mbështetje të entiteteve jo publike si dhe personave fizik si përfitues individual në gjendje të vështirë socio-ekonomike.

Në këto shpenzime, ne kemi testuar 6 mostra për teste substanciale në vlerë 11,400€ si dhe 15 mostra për teste të pajtueshmërisë. Për këto ne kemi trajtuar çështjen si në vijim:

Çështja A3 - Mos dërgimi i planit dhe raportit vjetor për miratim, për mbështetje financiar të OJQ-ve, në Zyrën e Kryeministrit

Gjetja Rregullorja MF Nr.04/2017 për subvencionimin e OJQ-ve, ka përcaktuar procedurat, kërkesat dhe kriteret për subvencionimin e OJQ-ve. Neni 6, pika 1 - ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor dhe i dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit.

Komuna kishte përgatitur planin vjetor për financimin e OJQ-ve, listën e OJQ-ve, individëve që kanë plotësuar kushtet për vlerësim si dhe vendimin e fitueseve të shpallur. Mirëpo të njëjtin plan si dhe raportin vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të për vitin 2019, nuk i kishte dërguar në Zyrën e Kryeministrit ashtu siç kërkohet me rregulloren.

Kjo kishte ndodhur për shkak të kujdesit jo të duhur të zyrtarëve përkatës që këtë plan të dorëzojnë me kohë në Zyrë të Kryeministrit.

Ndikimi Mos dërgimi i planit vjetor, për miratim si dhe raportit vjetor për mbështetje financiare, pamundëson sigurimin e transparencës dhe qasjes së publikut në shpenzimin e mjeteve për financimin publik të OJQ-ve.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të siguroj që plani dhe raporti vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve dërgohen në zyrën përkatëse të qeverisë duke respektuar kriteret e përcaktuara në ligj.

2.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 5,977,722€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 5,301,477€. Ato kanë të bëjnë me investime në ndërtimin e infrastrukturës rrugore dhe objekteve të ndryshme kapitale. Kemi testuar 79 mostra për teste substanciale në vlerë 2,293,451€, si dhe 8 mostra për teste të pajtueshmërisë. Për këto ne kemi trajtuar çështjet si në vijim:

Çështja B2 - Mos zbatimi i planit dinamik për realizimin e punimeve si dhe mos vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit të punimeve.

Gjetja

Në kontratat e nënshkruara për projektet kapitale ishin përcaktuar afatet kohore për realizimin punëve apo afateve për furnizimin e pajisjeve. Ndërsa me rregullat dhe udhëzuesin operativ për prokurimin publik, pika 30.6 specifikohet se, siguria e ekzekutimit mbetet valide për një periudhë tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës.

Gjatë testimit ne kemi vërejtur se realizimi i projekteve kapitale kishte vonesa si në vijim:

- Në projektin “Ndërtimi i rrugëve lokale "Perspektiva, Mustafaj, Rrustem Osmani, Dita e Flamurit, Zeqirve -Abazaj, Kovaqit" dhe ndërtimi i urës te lagjja e "Sopaj" në Mushtisht”, Komuna kishte nënshkruar një kontratë në vlerë 103,000€ në maj të vitit 2019, ku punët do të duhej të përfundonin brenda 90 ditë. Megjithatë punimet ende nuk kishin përfunduar, e që tregon se vonesat janë afër një vit;
- Në projektin “Ndërtimi i rrugës Freskia (segment), Luk Simoni dhe rrugët lokale në Sallagrazhdë” në vlerë 20,840€ e lidhur me datë 30.07.2019, punët do të duhej të përfundonin brenda 60 ditë, ndërsa ende nuk kishin përfunduar punimet, e që paraqet vonesa prej më shumë se gjashtë muaj në realizimin e këtij projekti;
- Në projektin “Punimi i fushave sportive në fshatin Grajqevc dhe punime tjera rinovuese” në vlerë prej 41,623€ e nënshkruar me 16.06.2019, punët do të duhej të përfundonin brenda 60 ditë, ndërsa punimet ende nuk kishin përfunduar apo ishin në vonesë shtatë muaj; dhe
- Në kontratën “Blerja e pajisjeve mjekësore për QKMF, QMF” kontratë e lidhur me datë 19.07.2019 në vlerë 56,130€, pranimi i furnizimeve ishte parapara në kontratë të bëhej brenda 30 ditëve, ndërsa furnizimi i tyre ishte bërë me 30.10.2019 me dy muaj vonesë. Për këtë kontratë nuk na është ofruar ndonjë sqarim nga komuna se pse ishin vonesat e tilla.

Sipas komunës për të gjitha projektet e lartë cekura arsyet e vonesave ishin si rezultat i prolongimeve të punimeve nga punë kryesit, për shkak të problemeve pronësore dhe mospajtimit të qytetarëve me disa pozicione të punimeve të parapara nga komuna në kontratë, si dhe nevojës për ndryshime të pozicioneve. E gjithë kjo rrjedhë si pasojë e projekteve dhe specifikimeve teknike jo të duhura nga ana e komunës dhe mos përshtatja e tyre me kushtet në teren.

Për më tepër komuna nuk kishte kërkuar vazhdimin e sigurisë së ekzekutimit të projekteve të lartcekura për të mbuluar vonesat në realizim të punimeve.

Ndikimi

Vonesat në realizimin e projekteve pa analizuar mirë projektet dhe kushtet për kryerje të punëve, ndikon në tej zgjatjen e realizimit të projekteve. Po ashtu, mund të rezultojë me dështim të projektit dhe mos arritjen e objektivave komunale, duke ndikuar në proceset buxhetore të projekteve tjera. Kujdesi jo i duhur lidhur me vazhdimin e sigurisë së ekzekutimit në raste të dëmtimit të punimeve/mallrave, komuna mund të përballet me shpenzime shtesë si dhe arrij kompensimin e dëmeve.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të ndërmerr masat për forcimin e kontrolleve lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të projekteve sipas planit dinamik dhe kushteve të kontratës, si dhe zgjidhjen e çështjeve pronësore dhe administrative para fillimit të punimeve, në mënyrë që mos të ketë ndërprerje të punimeve dhe projektet të realizohen sipas planit dinamik. Njëherit për projekte që janë në vonesa të realizimit të sigurohet se është kërkuar vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit.

Çështja A4 - Mos njoftimi i AQP-së për procedurat e jashtë planit të prokurimit

Gjetja Sipas nenit 9.6 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, nëse aktivitetet e prokurimit nuk janë përfshirë në planifikimin përfundimtar të autoritetit kontraktues, ZKA do të dërgojë në AQP një kopje të Deklaratës përkatëse të Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve së paku pesë (5) ditë para se Zyrtari Autorizues të autorizojë Zyrtarin e Prokurimit për iniciimin e aktivitetit përkatës të prokurimit.

Komuna në planin e prokurimit nuk kishte përfshirë të gjitha aktivitetet apo projektet e planifikuara, ajo kishte zhvilluar procedurat e tenderimit jashtë planit të prokurimit duke mos e njoftuar AQP-në për dy (2) projekte dhe atë si në vijim:

- Projektin “Ndërtimi i shtëpisë së kulturës Ukë Bytyqi në Suharekë-Faza e parë” me vlerë prej 747,897€, dhe
- Projektin “Ndërtimi i rrugës Ngucat-Javord” me vlerë 162,961€.

E gjithë kjo ka ndodhur si rezultat i kujdesit jo të duhur profesional të zyrtarëve përgjegjës në respektimin e kriterëve të përcaktuara në ligj.

Ndikimi Tenderimet jashtë planit të prokurimit duke mos njoftuar AQP-në mund të ndikojnë me shpenzim jo efikas të buxhetit dhe gjithashtu pasqyrojnë mungesë të vlerësimit të nevojave dhe planifikim të dobët të kërkesave.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë se plani i prokurimit është hartuar pas një analize të hollësishme të të gjitha njësive kërkuese dhe ka përfshirë sipas prioriteteve të gjitha projektet e planifikuara. Njëherit kur paraqiten nevoja për blerje jashtë planit duhet të vendosen mekanizma për njoftim paraprak të organeve relevante sipas kërkesave ligjore .

2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 282,890,745€, pasurive jokapitale është 674,509€, si dhe e stoqeve 55,466€. Kemi testuar 100 mostra për teste substanciale në vlerë 2,677,333€, si dhe 6 mostra për teste të pajtueshmërisë. Lidhur me këto kemi trajtuar si në vijim:

Çështja C2 - Parregullsi në menaxhimin dhe shpalosjen e pasurive në PFV

Gjetja Sipas nenit 6 të Rregullores MF Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare të Organizatave Buxhetore, çdo organizatë buxhetore duhet të krijoj dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që ka në menaxhimin e saj. Po ashtu, regjistri i pasurive duhet të përfshijë pasuritë kapitale mbi 1,000€ që duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuritë jo kapitale nën 1,000€ dhe stoqet në E-pasuri. Më tutje, neni 19, pika 4.7, përcakton se inventarizimi i pasurisë duhet të kryhet para përfundimit të PFV-ve.

Lidhur me testet tona ne kemi konstatuar si në vijim:

- Pasuria kapitale me vlerë mbi 1,000€ e prezantuar në PFV nuk ishte e saktë. Nga mostrat e testuara ne kemi identifikuar 10 pagesa me vlerë prej 183,225 € të cilat nuk ishin përfshirë në regjistrin SIMFK; dhe
- Pasuria nën 1,000€ e prezantuar në PFV nuk ishte e plotë. Vlera e pasurive e integruar në regjistrin e-pasuria ishte në vlerë prej 781,106€, ndërsa vlera prej 780,306€ ishte dërguar në MAP për integrim pas përgatitjes së PFV të vitit 2019.

Kjo ka ndodhur si rezultat i menaxhimit dhe kontrollit jo të mirë nga personat përgjegjës, për të harmonizuar pagesat dhe regjistrimet në regjistra përkatës.

Po ashtu, komisioni i inventarizimit të pasurisë në komunë, nuk kishte arritur të përfundoj raportin para përgatitjes së PFV.

Komisioni raportin e kishte përfunduar me datën 21.05.2020 dhe rrjedhimisht asnjë rezultat i inventarizimit nuk është reflektuar në PFV.

Ndikimi Dobësitë e identifikuara në menaxhimin e pasurisë që kanë të bëjnë më mos regjistrimin e pasurive kapitale si dhe procesit të inventarizimit, ndikojnë në raportimin e informatave jo të sakta për pasurinë e komunës dhe vlerën e tyre në PFV. Njëherit, rrit rrezikun e keqpërdorimit dhe keq menaxhimit të tyre.

Rekomandimi C2 Kryetari, duhet të ndërmerr masa për të siguruar se pasuritë mbi dhe nën 1,000€ janë regjistruar në regjistrat përkatës, për të gjitha pasuritë që ka në posedim në mënyrë që prezantimi i informatave në PFV të jetë i saktë dhe i plotë. Njëherit duhet të siguroj që raporti i inventarizimit merret në konsideratë para përgatitjes së PFV.

2.3 Të arkëtueshmet

Komuna e Suharekës në PFV e vitit 2019 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 4,674,508€. Prej tyre, 2,849,806€ janë nga të hyrat e tatimit në pronë, 1,289,586€ nga taksat e bizneseve në veprimtari si dhe 535,116€ prej të hyrave nga dhënia në shfrytëzim e pronës publike komunale.

Ne kemi testuar 83 mostra për teste substanciale në vlerë 553,023€, si dhe 12 mostra për teste të pajtueshmërisë. Për këto ne kemi trajtuar çështjet si në vijim:

Çështja B3 – Sfidat në menaxhimin e të arkëtueshmeve

Gjetja Në kontratat e lidhura në mes të komunës dhe qiramarrësve janë paraparë masat që duhet të ndërmerren në rast të mos pagesës së qirasë sipas kriterëve të përcaktuara në kontratë. Më tutje, në nenin 3 të kontratave, ishte specifikuar që kontrata të ripërtërihet çdo vit për shkak të një monitorimi më të mirë, megjithatë ato nuk ishin ripërtërirë

Nga testimi i 11 kontratave për shfrytëzimin e pronës publike, identifikua se, për shkak të mos pagesës mujore apo vjetore nga qiramarrësit sipas kontratave, komuna nuk kishte arritur t'i arkëtojë të hyrat nga borxhi i akumuluar në vlerë totale prej 155,776€.

Në gjashtë kontrata prej 11 kontratave të cekura më lartë, afati kohor i kontratave kishte skaduar, ndërsa ato nuk ishin përtërirë. Madje ngarkesa vjetore ishte bërë duke u bazuar në kontratën paraprake. Arsyeja e mos vazhimit të kontratave ishin problemet pronësore dhe objektet shumë të vjetra dhe se sipas zyrtarëve përgjegjës të komunës pas miratimit të planit zhvillimor komunal do të definohet edhe statusi i këtyre pronave.

Ndikimi Niveli i ulët i inkasimit të të arkëtueshmeve si dhe faturimi bazuar në kontrata të skaduara, ndikon që ato të bëhen të pa mbledhshëm duke krijuar një rast precedent për qiramarrësit e tjerë të cilët mund të ndjehen të trajtuar në mënyrë jo të barabartë madje edhe të mos inkasohen fare, në mungesë të një kontrate valide.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive opsionet e mundshme për të siguruar se dhënia në shfrytëzim e pronës mbulohet me kontrata duke u bazuar në rregulla dhe ligje në fuqi. Gjithashtu, për të gjitha pronat komunale të dhëna në shfrytëzim, komuna duhet të pranoj pagesën/qiranë e dakorduar bazuar në kontrata apo marrëveshje valide.

2.4 Detyrimet

2.4.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019, ishte 73,597€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020. Lidhur me testet tona, ne kemi vërejtur si në vijim:

Çështja B4 - Vonesa në realizimin e pagesave të obligimeve.

Gjetja Sipas nenit 39.1 të ligjit Nr.03/L-048 për MFPP që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.

Nga 5 mostrat e testuara ka rezultuar se të gjitha faturat me vlerë të përbashkët 37,881€, nuk ishin paguar brenda afatit të paraparë ligjor. Vonesat ishin duke filluar nga 55 ditë e deri në 5 muaj, përtej afatit të paraparë ligjor prej 30 ditësh. Kjo ka ndodhur në mungesë të zbatimit në tërësi të rregulloreve për shpenzimin e parasë publike nga zyrtarët përgjegjës. Si rrjedhojë e menaxhimit jo të mirë, për vitin 2019 ishin ekzekutuar pagesa direkt sipas vendimeve të Gjykatës Themelore në vlerë 178,315€.

Ndikimi Dështimet e pagesave ndaj furnitorëve në afatet ligjore, rritë rrezikun që planet e shpenzimeve aktuale të mos realizohen për shkak që komuna duhet t'i shlyejë obligimet e vitit paraprak. Kjo, gjithashtu, ka rezultuar edhe me padi gjyqësore apo pagesa direkte nga thesari që njëkohësisht kanë reflektuar me kosto shtesë.

Rekomandimi B4 Kryetari, duhet të konsiderojë që me rastin e planifikimit të buxhetit t'i trajtojë obligimet e mbetura me Ministrinë e Financave dhe të vendosë prioritetet buxhetore në kryerjen e tyre. Po ashtu, të gjitha faturat e konfirmuara apo vendimeve tjera për shpenzime, t'i kryejë me kohë sipas afatit të paraparë ligjor prej 30 ditëve.

2.4.2 Detyrimet e kontigjente

Pasqyra e detyrimeve kontigjente ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019, ishte 293,267€. Derisa në vitin 2018 vlera e detyrimeve kontigjente 388,533€, pas kontesteve gjyqësore dhe pagesave të obligimeve nëpërmes gjykatave ato mbeten si obligime për vitin fiskal raportues në shumë prej 293,267€.

2.4.3 Detyrimet e kontraktuale

Pasqyra e detyrimeve kontraktuale ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019, nuk është ofruar nga Komuna e Suharekës.

2.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me vetëm një anëtarë Drejtorin e NjAB-së. Përveç Planit strategjik, NjAB kishte hartuar edhe Planin vjetor të punës ku ishin paraparë të kryhen shtatë auditime që i përkisnin fushave me rrezik të lartë dhe të mesëm. Po ashtu, kishte përgatitur raportin gjashtë mujor dhe vjetorë, të cilin e kishte dërguar në Njësinë Qendrore Harmonizuese.

NjAB kishte arritur t'i përfundonte të gjitha auditimet e planifikuara të cilat i përkisnin periudhës së vitit aktual, duke dhënë 52 rekomandime, nga të cilat 21 ishin adresuar, 26 prej tyre ishin në proces të zbatimit dhe 5 nuk ishin adresuar ende.

Komiteti i Auditimit prej tre anëtarëve, gjatë vitit 2019 kishte mbajtur pesë takime. Në procesverbalet e takimeve vërehet se është shqyrtuar puna e NjAB, mirëpo ato ishin të përgjithësuara dhe nuk vërehej kontributi i KA në dhënien e sugjerimeve për menaxhmentin për marrjen e masave dhe veprimeve në lidhje me rekomandimet e dhëna nga auditimi.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2018 të Komunës së Suharekës ka rezultuar në 12 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojë rekomandimet e dhëna.

Komuna ka dorëzuar Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve (01 tetor dhe 12 mars) sipas kërkesave të daluara nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, pesë (5) rekomandime janë zbatuar, dy (2) rekomandime janë zbatuar pjesërisht, një ishte mbyllur ndërsa katër (4) rekomandime nuk ishin zbatuar ende.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve)

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Kryetari duhet të siguroj që gjatë planifikimit të buxhetit për organizatën, të vlerësohen nevojat reale të komunës me qëllim që të bëhet një planifikim adekuat i buxhetit dhe të eliminohen gabimet në klasifikimin e shpenzimeve nëpër kategori përkatëse ekonomike. Po ashtu, të konsideroj si prioritet çështjen e menaxhimit të pasurisë, përkatësisht regjistrimin e plotë të pasurisë, e cila do të reflektohet drejt edhe në paraqitjen e PVF.	Edhe në këtë vit kemi keq klasifikime, shih kapitullin 2.1. Ndërsa çështjet e menaxhimit të pasurive janë trajtuar te nen kapitujt përkatës.	I përsëritur.
2	Të hyrat	Kryetari duhet të rishikojë funksionimin e kontrollit në këtë fushë, duke siguruar, që të përditësohet me kohë sistemi nga zyrtaret e tatimit në pronë në bashkëpunim me Departamentin e Tatimit në Pronë në Ministrinë e Financave, që të dhënat në sistem lidhur me tatimin në pronë të azhurnohen të vlerësohen dhe menaxhohen bazuar në rregulloren e tatimit në pronë.	Ne gjatë auditimit të vitit 2019 nuk kemi vërejtur ndonjë parregullsi gjatë regjistrimit dhe menaxhimit të hyrave nga tatimi në pronë.	I zbatuar.
3	Mallra dhe Shërbime	Kryetari duhet të siguroj se, mallrat të cilat duhet të jenë të identifikuar me numër, serik, të përfshihen në fletë dërgesë/faturë dhe specifikat tjera të domosdoshme, për tu siguruar se është pranuar malli në pajtim me specifikat dhe çmimet e kontraktuara. Po ashtu të sigurojë se në përbërje të komisioneve të caktohet edhe ndonjë anëtarë ekspertë për fushën përkatës dhe komisionet të përgatisin raporte për pranimin e mallit.	Edhe këtë vit kemi vërejtur pjesërisht të njëjtën çështje, shih C1.	Pjesërisht i zbatuar.
4	Investime Kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që njësia kërkuese fillimisht të bëjë vlerësimin e nevojave për ekzekutim të punëve e pastaj të hartojë projektin (paramasën), po ashtu ndryshimet në pozicione të bëhen duke aplikuar procedurat e prokurimit.	Gjatë testeve kemi vërejtur që nuk kemi ndryshimet janë bërë me aprovime sipas kërkesave ligjore.	I zbatuar.

5		Kryetari duhet të ndërmerr masat për forcimin e kontrolleve lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të projekteve sipas planit dinamik dhe kushteve të kontratës, si dhe zgjidhjen e çështjeve pronësore dhe administrative (marrjen e lejeve përkatëse) para fillimit të punimeve, në mënyrë që mos të ketë ndërprerje të punimeve dhe projektet të realizohen sipas planit dinamik.	Edhe këtë vit , ne kemi vërejtur që komuna kishte vonesa në implementim të planit dinamik. Shih çështjen B2.	I përsëritur.
6	Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se në fushën e prokurimit janë duke u zbatuar kontrollet nga ana e zyrës së prokurimit, në këtë kontest, kriteret nuk duhet të përmbajnë marka të caktuara tregtare dhe kërkesat tjera të nevojshme të jenë të pranuar në formë elektronike sipas RrUOP, me qëllim të arritjes së synimeve për realizimin e mirëfilltë të kontratave.	Ne gjatë auditimit të vitit 2019 nuk kemi vërejtur raste të tilla.	I zbatuar.
7		Kryetari duhet të vendos kontrolle adekuate dhe monitorim të përshtatshëm për tu siguruar se zbatohen të gjitha kërkesat ligjore gjatë prokurimit dhe komuna aplikon garanci për tu siguruar se ekzekutimi punëve, mallrave apo shërbimeve bëhet në përputhje me marrëveshjet.	Ne nuk kemi vërejtur raste të tilla për vitin 2019.	I zbatuar.
8	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet t'i rishikojë kontrollet lidhur me menaxhimin e pasurive dhe të sigurojë regjistrim të saktë dhe të plotë të tyre. Po ashtu, të sigurojë trajnimet e domosdoshme për zyrtarët përkatës, që pasuritë të regjistrohen-plotësohen me informatat e nevojshme (barkode, nr. serik etj.) dhe shpalosen në përputhje me kërkesat ligjore duke ofruar transparence të plotë për përdoruesit	Komuna kishte bërë përpjekje që të identifikonte gjithë pasurinë me vlerë nën 1,000€, mirëpo nuk kishte arritur që t'i regjistronte dhe t'i integronte në regjistrin e e-pasurisë para përgatitjes së PFV-vë të vitit 2019.	Pjesërisht i zbatuar.

9	Të arkëtueshmet	Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive opsionet e mundshme për të siguruar se dhënia në shfrytëzim e pronës mbulohet me kontrata duke u bazuar në rregulla dhe ligje në fuqi. Gjithashtu, për të gjitha pronat komunale të dhëna në shfrytëzim, komuna duhet të pranoj pagesën/qiranë e dakorduar bazuar në kontrata apo marrëveshje valide.	Edhe këtë vit kemi të njëjtën çështje, lidhur me sfidat në menaxhimin e të arkëtueshmeve.	I përsëritur.
10		Kryetari duhet të sigurohet që lista të jetë e përditësuar me bizneset aktive dhe ato të shuara çdo vit në mënyrë që të ketë një vlerësim të saktë të llogarive të arkëtueshme. Po ashtu, të aplikohen masa konkrete për zvogëlimin e të arkëtueshmeve të akumuluar ndër vite. Për më tutje, fshirja e obligimeve të akumuluar për disa vite duhet të shqyrtohet në Kuvendin Komunal.	Janë ndërmarr masa nga menaxhmenti.	I zbatuar.
11	Obligimet e papaguara	Kryetari, duhet të konsiderojë që me rastin e planifikimit të buxhetit t'i trajtojë obligimet dhe detyrimet kontingjente të mbetura me Ministrinë e Financave dhe të vendosë prioritetet buxhetore në kryerjen e tyre. Po ashtu, të gjitha faturat e konfirmuara apo vendimeve tjera për shpenzime, t'i kryejë me kohë sipas afatit të paraparë ligjor prej 30 ditëve.	Edhe këtë vit kemi të njëjtën çështje, lidhur me vonesat ne pagesa.	I përsëritur.
12	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryetari, duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, plani i prokurimit, menaxhimi i pasurisë dhe menaxhimi i llogarive të arkëtueshme, duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontrollë kërcënimet e ekspozuara.	Kjo çështje nuk do të trajtohet në raportin e auditimit të vitit 2019.	I mbyllur.

Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019
1	Planifikimi dhe realizimi i buxheti	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo ridestitim të mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.
2	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj se verifikimi i pronave komunale do të bëhet shtu siç parashihet me ligj, për të reflektuar gjendjen reale të pronave të tatuara, që rezulton me të hyra të sakta komunale si dhe performancë më të mirë buxhetore.
3		Kryetari i komunës duhet të forcojë kontrollet në menaxhimin e pronave të paluajtshme të dhëna në shfrytëzim, si dhe të sigurojë që çdo pronë të ngarkohet me taksë, në përputhje me kushtet dhe hapësirën shfrytëzuese të pronës komunale.
4	Mallra dhe Shërbime	Kryetari duhet të sigurojë që me rastin e pranimit të shërbimeve dhe furnizimeve të caktohen komisionet për pranimin e tyre konform dispozitave të udhëzimeve dhe rregulloreve në fuqi.
5	Subvencione dhe Transfere	Kryetari duhet të siguroj që plani dhe raporti vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve dërgohen në zyrën përkatëse të qeverisë duke respektuar kriteret e përcaktuara në ligj.
6	Investime Kapitale	Kryetari duhet të ndërmerr masat për forcimin e kontroleve lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të projekteve sipas planit dinamik dhe kushteve të kontratës, si dhe zgjidhjen e çështjeve pronësore dhe administrative para fillimit të punimeve, në mënyrë që mos të ketë ndërprerje të punimeve dhe projektet të realizohen sipas planit dinamik.
7		Kryetari duhet të sigurojë se plani i prokurimit është hartuar pas një analize të hollësishme të të gjitha njësive kërkuese dhe ka përfshirë sipas prioriteteve të gjitha projektet, për të cilat janë siguruar fondet e duhura buxhetore, dhe në fund të sigurojë transparencë dhe korrektësi në prezantimin e të gjitha kontratave të nënshkruara.
8	Pasuritë kapitale dhe jokapitale	Kryetari, duhet të ndërmerr masa për të siguruar se pasuritë mbi dhe nën 1,000€ janë regjistruar në regjistrat përkatës, për të gjitha pasuritë që ka në posedim në mënyrë që prezantimi i informatave në PFV të jetë i saktë dhe i plotë. Njëherit duhet të siguroj që raporti i inventarizimit merret në konsideratë para përgatitjes së PFV.
9	Të arkëtueshmet	Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive opsionet e mundshme për të siguruar se dhënia në shfrytëzim e pronës mbulohet me kontrata duke u bazuar në rregulla dhe ligje në fuqi. Gjithashtu, për të gjitha pronat komunale të dhëna në shfrytëzim, komuna duhet të pranoj pagesën/qiranë e dakorduar bazuar në kontrata apo marrëveshje valide.
10	Detyrimet e papaguara	Kryetari, duhet të konsiderojë që me rastin e planifikimit të buxhetit t'i trajtojë obligimet e mbetura me Ministrinë e Financave dhe të vendosë prioritetet buxhetore në kryerjen e tyre. Po ashtu, të gjitha faturat e konfirmuara apo vendimeve tjera për shpenzime, t'i kryejë me kohë sipas afatit të paraparë ligjor prej 30 ditëve.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit


157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër e Konfirmimit



KRYETARI I KOMUNËS

Datë 08.07.2020

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Suharekës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 "Raporti i auditimit të pasqyrave financiare të Komunës së Suharekës".
- Pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimit, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tij.

KRYEFARI I KOMUNËS

Bali Muharremaj

